



**Si ta
rregullojmë
një shtëpi
fshati**

Ky publikim është zhvilluar në kuadër të projektit “Shndrimi i fshatrave tonë në destinacione turistike”, i cili zbatohet nga Komuna e Pejës me Agjencinë për Zhvillim Rajonal – Perëndim në Kosovë, dhe me Agjencinë për Zhvillim Rajonal – Bjellashica, Komovi dhe Prokletije në Mal të Zi. Projekti është i financuar nga BE-ja përmes Programit të Bashkëpunimit Ndër-kufitar Mal i Zi – Kosovë.



Projektin e zbatojnë:



Komuna Pejë



Projektin e bashkë-financojnë:

Projekti financohet nga:



**Funded by
the European Union**



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020



Komuna Pejë



Ministarstvo javne uprave

Qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë nën përgjegjësinë e Komunes së Pejës dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal -Perëndim dhe nuk përfaqësojnë medoemos qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Turizmi rural dhe rregullimi i amvisërisë

Rreth këtij publikimi

Në kuadër të projektit “Shndrimi i fshatrave tonë në destinacione turistike”, një nga aktivitetet ishte edhe këshillimi dhe aftësimi i familjeve të interesuara në turizëm rural se si te bëhet rregullimi i brendshëm i shtëpive që do përdoren për turizëm rural. Në këtë aktivitet jemi mbështetur nga AZHR-BKP nga Mali i Zi të cilët ndanë me ne përvojën dhe hulumtimet e tyre në fushën e turizmit rural dhe në rregullimin e brendshëm të shtëpive të përzgjedhura. Përmes kësaj pune, kemi arritur në disa përfundime të cilat dëshirojmë t'i ndajmë me të gjithë ju që planifikoni ose jeni të angazhuar tashmë në turizmin rural, në mënyrë që mos të bëhen gabime, si dhe të rregulloni shtëpinë tuaj në mënyrën më të mirë. Shpresojmë që këto përvoja ndër-kufitare dhe rekomandime do të jenë të dobishme për ju!

Amvisëritë rurale që ofrojnë shërbime në turizëm nuk janë thjesht vetëm një akomodim. Amvisëria rurale shet në fakt përvojën e plotë të qëndrimit në fshat, e kjo përfshin aktivitete të ndryshme rurale, ushqime vendore dhe produkte tipike si dhe traditë rurale të demonstruar nga vetë familja. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të kujdeseni që shtëpia të jetë rustike, e integruar në mjedis dhe që pjesa e brendshme të jetë sa më tipike për zonat rurale. Duke ditur që gabimet mund të bëhen në këtë kuptim, ne ju prezantojmë këtë botim të lehtë dhe të ilustruar, në të cilin mund të gjeni ndonjë këshillë që mund t'ju ndihmojë!

Një amvisëri rurale që ofron shërbime në turizmin rural duhet të kujdeset që shtëpia të jetë e rregulluar në përputhje me traditën e zonës në të cilën ndodhet, ose me traditën e vetë familjes. Çdo amvisërie, si një nga hapat e parë, i rekomandohet të zgjedhë emrin e amvisërisë së saj, diçka karakteristike për familjen ose vendndodhjen ku ndodhet shtëpia. Emri duhet të jetë i personalizuar, nuk duhet t'i ngjajë të tjerëve, duhet të jetë po aq autentik sa vetë amvisëria. Në kushte ideale, rregullimi i shtëpisë mund të fillojë nga vetë emri, në mënyrë që gjithçka të jetë në harmoni.

Dhe kur filloni të rregullimin, parimet bazë duhet të jenë si më poshtë:

- Në dekorimet dhe mobiljet, shmangni plastikën, metalin, llakun, shkëlqimin, çdo gjë që u jep një ndjesi industrial objekteve dhe mobiljeve në shtëpinë tuaj. Gjithmonë zgjidhni gjëra që janë të punuar me dorë, edhe nëse nuk janë bërë në mënyrë perfekte, ato janë më të vlefshme dhe mysafirëve tuaj do t'i pëlqejnë më shumë.
- Kërkoni nepër bodrume, qilare dhe tavane dhe gjeni mjete të vjetra, enë, dru të vjetër, çdo gjë me një dukje të vjetër që mund të përdoret.
- Mos teproni me dekorimet, shumë gjëra të vjetra dhe shumë dekorime mund ta bëjnë hapësirën të duket e çrregullt dhe e stërmbushur dhe ju nuk e dëshironi këtë.
- Nëse nuk jeni të sigurt se si ta rregulloni shtëpinë tuaj, konsultohuni me dikë, mos humbisni para dhe kohë në mënyrë të gabuar.


Ne kemi përgatitur për ju disa këshilla në lidhje me rregullimin e brendshëm dhe jemi të sigurt se nëse i ndiqni ato, amvisëria e juaj do të duket më e bukur dhe më autentike.



Dritaret

Provoni t'i dekoroni me perde të punuar me dorë. Nëse shtëpia juaj është e vjetër prej guri, me mure të trasha, mos i fshihni dritaret dhe mos i mbuloni plotësisht me perde. Perdet vitrazh janë zgjedhja juaj më e mirë. Është e njëjta gjë me dritaret që ofrojnë një pamje të këndshme andaj ruajeni pamjen, dhe mos e teproni me perde. Shmangni perdet e kuqe apo perdet me katrorë, edhe pse ngjajnë me ato rustike këto hasen kudo. Qëllimi juaj është që të jeni ndryshe. Punimet e qëndisura dhe me grep janë opsioni më i mirë për shtëpitë tradicionale, ndërsa në shtëpitë më të reja mund të përdorni materiale të tjera, njëngjyreshe me xhufka shumëngjyreshe dhe dekorime të ngjashme rustike.








Mobilet

Kërkoni nëpër bodrume. Me siguri aty fshihet një thesar i vërtetë që mund të restaurohet dhe të vihet sërish në përdorim. Arka të vjetra, tavolina, karrige, rafte, nëse druri nuk është i kalbur, sigurisht që mund t'u jepet një jetë e re. Ky lloj i mobileve do ti jep frymën e së kaluarës shtëpisë tuaj ndërsa me detaje hapësirës do ti jepni ngrohësi.

Nëse nuk keni mobilie të vjetra, mos u shqetësoni. Merrni mobilie me linja të thjeshta dhe një dizajn të thjeshtë, të cilave pastaj me detaje tradicionale ju do të mund t'i jepni një frymë rustike dhe antike. Shmangni sipërfaqet me llak kur bëhet fjalë për tavolina dhe karrige. Përdorni ngjyra natyrale të drurit me teksturë mat.







Kuzhinat dhe dhomat e ngrënies

Këto hapësira duhet të rregullohen në përputhje me qëllimin e tyre, dhe hapësira duhet të jetë e këndshme për qëndrimin e mysafirëve. Sigurohuni që mbulesat e tavolinës në dhomën e ngrënies të jenë tradicionale, tavolinat të jenë të thjeshta dhe me mbulesën e tavolinës do t'i jepni ngjyrë dhe hijeshi. Përdorni si dekorim një takëm të vjetër, garuzhdë, tenxhere apo kazan bakri, çdo gjë që lidhet me ushqimin. Mbushni legenin me lule të thata, kallinj, arra dhe lajthi, produkte që mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë dhe janë dekorative. Nëse keni ruajtur punime të qëndisura që dikur vareshin në kuzhina dhe dhoma të ngrënies, do të ishte mirë t'i përdorni ato.







Raftet

Çfarëdo që të bëni, mos blini rafte industriale! Të paktën kjo është e lehtë. Një tra, një dërrasë, sa më rustik aq më mirë, do të përshtatet lehtësisht dhe do të montohet lehtë. Nëse keni fatin të gjeni një dollap kuzhine, do të jetë një gjë shumë e qëlluar. Rifreskojeni ngjyrën e tij, më së shpeshti ato ishin dikur në ngjyrë të kaltër të çelët ose të gjelbër por mund të jetë edhe ngjyra natyrale e drurit të vjetër. Me çdo kusht, përpikuni të gjeni diçka të vjetër, dhe nëse jo, atëherë një copë më e thjeshtë e drurit mund të bëhet një raft, të cilën mysafiri mund të përdor për të vënë diçka, por mund të përdoret gjithashtu edhe si material dekorativ ose reklamuese, ose për ndonjë gjë që nevojitet. Nëse ka një thellim në mur, edhe atë mund ta përdorni si raft. Ajo që ju rekomandojmë është që të keni rafte të tillë në shtëpinë tuaj, dhe se duhet të bëni diçka të tillë në hapësirat e përbashkëta ku mund të ekspozoni produkte ose suvenire nga amvisria e juaj








Llambat, llambadarët dhe shandanët

Edhe ky detaj është i rëndësishëm. Në një ambient rustik nuk do të përshtatet çfarëdo llambadari, mund të prishë gjithçka. Ndaj kërkoni diçka të vjetër edhe për këtë detaj. Ne rekomandojmë një sitë për sitje të miellit, edhe nëse është i dekoruar do të duket edhe më mirë. Fenerët e vjetër mund të shndërrohen në një llambë ose llambadar. Vetëm kini kujdes me instalimet elektrike dhe poçet elektrike, që të mos shkaktoni zjarr me llambadarin tuaj të improvizuar! Mos blini shandanë, nga një kavanoz qelqi i zakonshëm mund të bëni një shandan të bukur, rustik, siç mund ta shihni në foto.







Vazot dhe saksitë

Sigurohuni që edhe këto të mos jenë industriale, të paktën kjo është lehtë të bëhet. Në një shtëpi tradicionale, një gaviç i vogël në të cilin do të fusni një kavanoz qelqi për t'u siguruar që uji të mos rrjedhë, do të bëhet një vazo ideale për lule. Një gaviç pak më i madh, ose një tenxhere e vjetër që nuk e përdorni më, do të bëhen vazo lulesh, qoftë edhe nëse ato qëndrojnë jashtë ose brenda. Dhe lulet janë shumë të rëndësishme për çdo shtëpi, që në shikim të parë ngrohin dhe zbukurojnë hapësirën, ndaj mos ngurroni t'i vendosni para ardhjes së çdo mysafiri. Lulet e fushës janë më të mirat!







Shtretërit

Më së miri do të ishte që shtretërit të janë të thjeshtë, prej druri dhe me dyshekë të rehatshëm. Është e vështirë të gjesh shtretër të vjetër me ballë shtrati të vjetër. Prandaj, në një shtëpi tradicionale, merrni shtretërit më të thjeshtë. Por mbulojini me shtroja të qëndisura, ai shtrat nuk do të ketë nevojë për një dekorim më të bukur. Nëse nuk keni shtroja të qëndisura, atëherë përdorni ato të thjeshta, një ngjyrëshe, të cilat do të jenë në përputhje me mbulesën e shtratit, i cili do të duhej të ishte tradicional, i endur ose i thurur.





Objektet tradicionale si dekorime

Sa herë që është e mundur dhe sa herë që përshtatet me ambientin, përdorni objekte dhe mjete të vjetra që nuk përdoren më, si dekor për dhomat tuaja. Sigurisht, gjithçka me masë. Hekurat e vjetër, fenerët, legenët, kallëpet për opinga, djep, çdo gjë që është antike dhe qëndron nëpër tavane dhe bodrume, hulumtoni se çfarë keni dhe gjeni një vend për të. Por mos e teproni, nëse vendosni shumë nga këto sende shumë afër njëri-tjetrit, asgjë nuk do të vërehet dhe do të duket si e stërm bushur dhe jo e këndshme për syrin.





Stolit dhe dekorime tjera

Siç e kemi përsëritur shumë herë, përpiquni të hiqni çdo gjë që ka një ndjesi industriale nga shtëpia juaj. Përpiquni ta dekoroni shtëpinë me objekte të punuara me dorë nga materiale natyrale, druri, guri, leshi e të ngjashme. Këtu mund të jeni vërtet kreativ dhe nëse nuk jeni të mirë në këto gjëra, kërkonit këshilla ose ndihmë.

Në foto do të shihni gjësende tek amvisëritë të cilat konsiderohen të përshtatshme për dekorim, dhe ndoshta këta shembuj do t'ju japin ide. Por gjithmonë përpiquni t'i bëni dekorimet tuaja të jenë veçanta dhe unikate, dhe jo thjesht një kopje të një gjëje që keni parë tek dikush tjetër.







Rregullimi i jashtëm

Përveç në brendësi të shtëpisë tuaj, mysafirët tuaj me siguri do të qëndrojnë në kopsht, andaj edhe atje duhet t'i kushtoni vëmendje detajeve. Ne kemi thënë tashmë, saksitë e luleve janë domethënëse, shtretërit e luleve të kufizuara me gurë, thurje ose dru. Përdorni shkallët e vjetra sa herë që mundeni, nga ato mund të bëhen shumë gjëra ndërsa mund të shihni edhe disa shembuj në fotot tona. Rrethojat në oborr gjithashtu duhet të jenë rustike – rrethoja druri apo baskë, nuk ju duhet asgjë tjetër, të kombinuara me lule. Mbani të rregulluar mirë oborrin, përpikuni të eliminoni gjithçka që është plastike, lërinë të dominojnë materialet natyrore. Kashtët, objektet ndihmëse, kuzhinat, koshët e drithërave, të gjitha këto janë elementë të vërtetë rustikë të cilat aspak nuk pengojnë, por përkundrazi kontribuojnë në pamjen e bukur dhe rurale të oborrit tuaj. Përpikuni ta fshihni pjesët e makinave, veglat, gomat e makinave dhe traktorëve, rrënojat dhe të ngjashme - diku ku nuk mund të shihen. Ndhuni të lirë të varni një tufë barishte të thata, ose një kurorë me qepë, kallinj në derën e shtëpisë, kjo fare nuk pengon dhe është diçka që mund të shihni në shtëpitë e zakonshme në fshat. Detaje të tilla do të kompletojnë ambientin rustik. Shmangni mjellmat dhe luanët industrialë ë bëra nga gipsi, vazot e luleve prej gome ose çimento sepse dekorime të tilla nuk janë pjesë e mjedisit rural dhe nuk përshtaten.





